

# SHËRBIMET E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË RAJONIN E DANUBIT



# PROFILI I VENDIT: SHQIPËRIA

Situata e sektorit | maj 2015



## SFIDAT KRYESORE TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

- ▶ **Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve.** Objektivi afatgjatë i qeverisë në fushën e ujësjellës-kanalizimeve është arritja e shërbimeve të qëndrueshme të ujësjellës-kanalizimeve që përkohë me standardet që kërkon anëtarësimi në BE, si në qytet ashtu edhe në fshat. Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve nuk i kanë përmbushur sa duhet parimet e mbajtjes së kostove në kontroll, përmirësimin të vazhdueshëm të efikasitetit dhe mbulimit të plotë të kostos, çka shkakton një rreth vicioz me ofrues shërbimesh pa fonde, investime të pamjaftueshme dhe përkeqësim të infrastrukturës, sidomos në lidhje me ujërat e zeza.
- ▶ **Shndërrimi i rezultatit të reformës territoriale në shërbime ujësjellës-kanalizime për të gjithë, sidomos në fshat.** Një përqindje jo e papërfillshme e popullsisë në fshat nuk merr furnizim me ujë me tubacione. Reforma e planifikuar territoriale-administrative do të eliminojë një numër të madh njësisish të qeverisjes vendore në fshat, që aktualisht ofrojnë shërbime UK në këto zona, të cilat do të duhet të integrohen në struktura të reja ose ekzistuese të ofrimit të shërbimeve. Thelbësor do të jetë krijimi i mekanizmave dhe stimuljeve të duhur të llogaridhënies, për të siguruar që nga reforma të përfitojnë të gjithë shtetasit dhe jo vetëm përfituesit ekzistues nga shërbimet.
- ▶ **Rritja e kapacitetit të punonjësve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.** Niveli i tanishëm i pajisjes me personel të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve është mbi standardet rajonale, ndërkohë që ka një qarkullim të ndjeshëm të punonjësve, çka e pengon profesionalizimin e ofrimit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve. Nevojitet mbështetje për politika të rritjes së kapaciteteve, për të siguruar dhe fuqizuar ekzistencën e një personeli profesional të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.



## BURIME TË TJERA

### Për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në Rajonin e Danubit

- ▶ Raport rajonal që analizon situatën e sektorit në rajon, si edhe profilet e hollësishme për 15 vende të tjera, gjenden në hapësirën në internet: [SoS.danubis.org](http://SoS.danubis.org)
- ▶ Të dhëna të hollësishme për ecurinë e ndërmarrjeve, kur ka, gjenden në: [www.danubis.org/eng/utility-database](http://www.danubis.org/eng/utility-database)



### Për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri

Rekomandohen këto dokumente për lexim të mëtejshëm; këto, dhe të tjera dokumente, gjenden në [www.danubis.org/eng/country-resources/albania](http://www.danubis.org/eng/country-resources/albania)

- ▶ ERRU. 2011/2012/2013. *Raport mbi ecurinë e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve*, Tiranë: Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndoturat, Shqipëri.
- ▶ MPPT. 2011. *Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017*. Tiranë: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

**Falënderime.** Ky material është produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Botës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë material. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe informacionet e tjera që jepen në harta në këtë material nuk përfaqësojnë asnjë gjykim nga ana e Bankës Botërore sa i takon statusit juridik të ndonjë territori apo pranimit apo miratimit të këtyre kufijve.

Ky material është hartuar nga Semira Kasimati Vathi, konsulentë vendore, me mbështetjen e Maria Salvetti, konsulente, në bazë të të dhënave të mbledhura nga analizuara nga Semira Kasimati Vathi. Ky material është pjesë e një shqyrtimi të situatës së sektorit, nën udhëheqjen e David Michaud, Banka Botërore, në kuadër të Programit të Ujësjellës-Kanalizimeve të Danubit, financuar nga Ministria e Financave e Austrisë, për të cilën e falënderojmë. Autorët mirëpresin komentet, të cilat mund të drejtohen tek David Michaud ([dmichaud@worldbank.org](mailto:dmichaud@worldbank.org)).

**Të drejta dhe leje.** Materiali i këtij botimi është objekt i të drejtës së autorit. Ngaqë Banka Botërore e nxit përhapjen e njohurive të saj, ky botim mund të riprodhohet, i plotë ose pjesërisht, për qëllime jotregtare, me kusht që të citohet titulli i tij. Pyetjet për të drejtat dhe lejet mund t'i drejtoni tek: Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2422; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET

Burimet për të gjitha shifrat në këtë faqe jepen plotësisht në faqen e këtij vendi; përshkrimi i plotë i metodikës jepet në Raportin Rajonal për Situatën e Sektorit, në adresën SoS.danubis.org.

	Vlera	Viti	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
<b>Te dhena te pergjithshme</b>				
PBB për frymë, PPP [\$/]	10,489	2013	16,902	n.a.
Popullsia [milion banorë]	2.774	2013	8.451	n.a.
Niveli i varfërisë [2.50 \$ në ditë PPP] [% e popullsisë]	6.7	2012	1.65	n.a.
Njësi të qeverisjes vendore [bashki]	374	2014	1,987	n.a.
Me madhësi mesatare [banorë]	7,416	2013	4,253	n.a.
Sasia gjithsej e ujit të ripërtëritshëm [m <sup>3</sup> /frymë/vit]	12,922	2008-2012	7,070	n.a.


<b>Organizimi i shërbimeve</b>				
Numri i ofruesve zyrtar të shërbimeve	58	2013	661	n.a.
Numri i mesatar i banorëve që u ofrohen shërbimet	36,822	2013	9,498	n.a.
Ka ligj për shërbimet e ujit?	Jo			
Ministri linje e vetme?	Po [Ministry of Transport and Infrastructure]			
Ent rregullator?	Po [ERRU]			
A gjenden publikisht treguesit e ecurisë së ndërmarrjeve?	Po [www.erru.al]			
A ka reforma madhore në proces?	Përshtatja e strukturave dhe drejtimit të brendshëm të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve me reformën e tanishme territoriale			

<b>Mundësia për të përfituar nga shërbimet</b>				
Furnizim me ujë me tubacione (%)	78	2012	83	100
Tualet me ujë të rrjedhshëm (%)	89	2012	79	99


<b>Ecuria e shërbimeve</b>				
Vijueshmëria e shërbimit [orë/ditë]	12	2013	20	24
Uji pa të ardhura [m <sup>3</sup> /km/d]	68	2013	35	5
Indeksi i ecurisë së NUK-ve [WUPI]	51	n.a.	69	94

<b>Financimi i shërbimeve</b>				
Mbulimi i kostove të shfrytëzimit	0.95	2013	0.96	1.49
Tarifa mesatare për familjarë [€/m <sup>3</sup> ]	0.74	2013	1.32	n.a.
Përqindja që zënë shpenzimet për SHUK në të ardhurat mesatare [%]	2.2	2012	2.6	n.a.
Investimet vjetore mesatare [€/frymë/vit]	15	n.a.	23	n.a.


## Mundësia e përfitimit të shërbimeve: të ardhura mesatare, 40% të fundit dhe të varfrit



## Struktura e sektorit



## Vlerësimi i qëndrueshmërisë



Në bazë të treguesve të normave, as më afër kufijve aq më i mirë është treguesi

Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit	Vlera	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
	55	64	96

# TE DHENA TE PERGJITHESHME PER SHËRBIMET

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
<b>Situata shoqërore-ekonomike</b>						
Popullsia [million banorë]	2013	Banka Botërore 2015	2.774	3.053	8.451	n.a.
Rritja e popullsisë [shkalla e përbërë e rritjes 1990 – 2013] [%]	1990-2013	Banka Botërore 2015	-0.74	-0.33	-0.37	n.a.
Përqindja e popullsisë në qytet [%]	2013	Banka Botërore 2015	55	51	63	n.a.
PBB për frymë, PPP [\$]	2013	Banka Botërore 2015	10,489	11,154	16,902	n.a.
Niveli i varfërisë [2,50 \$ në ditë [PPP] [% e popullsisë]]	2012	Banka Botërore 2015	6.7	3.55	1.65	n.a.
<b>Organizimi administrativ</b>						
Numri i njësjve të qeverisjes vendore [bashki]	2014	MSCV 2014	374 (to be 61)	85	1,987	n.a.
Madhësia mesatare e NJQV-ve [banorë]	2013	Çmuarje të autorëve	7,416 (to be 45,469)	35,850	4,253	n.a.
<b>Burimet ujore</b>						
Sasia gjithsej e ujit të ripërtërisshëm [ $m^3$ /frymë/vit]	2008-2012	FAO Aquastat 2015	9,551	8,128	7,070	n.a.
Sasia vjetore e marrë nga ujërat e ëmbla, familjar [% e sasisë së marrë gjithsej]	2013	Banka Botërore 2015	43	18	26	n.a.
Përqindja e ujërave sipërfaqësore që përdoret si burim i ujit të pijshëm	2014	ICPDR 2015	17	42	31	n.a.

## **Ekonomia. Shqipëria është një vend me të ardhura të mesme, i cili ka bërë hapa të mëdhenj për ngritjen e një ekonomie të besueshme tregu gjatë dy dekadave të fundit.**

Shqipëria e mori statusin e vendit kandidat për t'u anëtarësuar në BE në qershor të vitit 2014. Në vend është ruajtur stabiliteti makroekonomik, por gjithsesi ka çekuilibra fiskalë për shkak të nivelit të lartë të borxhit publik he amortizatorëve të ezauruar fiskalë. Shqipëria vuan nga niveli i ulët i aftësisë konkurruese dhe nga një bazë e ngushtë prodhimi, ndërsa sektori privat frenohet nga dobësitë e mjedisit rregullator. Rritja reale e PBB-së arriti pikën e saj më të ulët, -2,3%, në tremujorin e tretë të vitit 2013. Faktori kryesor i ngadalësimit ka qenë kërkesë e dobët e brendshme, meqë konsumi privat dhe sidomos investimet u prekën negativisht nga një besim i dobët dhe huadhënie anemike. Ndryshimet politike dhe demokratike të fillimit të viteve 1990 sollën një sërë ndryshimet ekonomike dhe shoqërore. Profili demografik i Shqipërisë është karakterizuar nga tri dukuri kryesore: valë të mëdha migrimi brenda dhe jashtë vendit, rënie të shkallëve të vdekshmërisë dhe rënie të shkallëve të pjellorisë. Gjatë dekadës së fundit numri i popullsisë ra me 0,7%, por pati rritje të numrit të popullsisë në qytet (Banka Botërore 2015). Shumica e popullatës së varfër jeton në fshat. Niveli i varfërisë është thujse tri herë më i lartë në fshat se në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, dhe dy herë më i lartë se në zonat e tjera qytetëse. Grupet e pakicave kombëtare, ku përfshihen egjiptianët, grekët, maqedonasit, malazezët, romët dhe vllahët përbëjnë afërsisht 2% të popullsisë gjithsej në Shqipëri.

**Qeverisja. Shqipëria është republikë parlamentare, në formën e një shteti unitar dhe të pandashëm.** Për arsye historike, Shqipëria trashëgoi një strukturë territoriale-administrative me shumë njësi të qeverisjes vendore të vogla dhe të fragmentuara. Në korrik 2014, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin "Për ndarjen administrative dhe territoriale", me të cilin numri i NJQV-ve u zvogëlua nga 374 në 61. Kjo reformë duhet të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në fuqizimin e qeverisjes vendore. Në bazë të kuadrit të tanishëm ligjor të Shqipërisë, njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin dhe përgjegjësinë e plotë për ofrimin e shërbimeve publike, ku përfshihen edhe ujësjellës-kanalizimeve.

**Burimet ujore. Shqipëria ka burime relativisht të bollshme me ujëra të ëmbla.** Sasia mesatare e ujit të ëmbël të gatshëm çmohet se është 9 551  $m^3$ /frymë/vit (FAO Aquastat 2015), që është nga më të lartat në Evropë. Burimet e ujërave të ëmbla përbëhen nga burime natyrore, lumenj, liqene dhe akuifere nëntokësore. Burimet ujore në Shqipëri gjenden, hidrografikisht, në gjashtë basene ujëmbledhëse, të cilat rrjedhin duke ndjekur një drejtim perëndimor ose veriperëndimor, në të gjithë vendin dhe kanë si sisteme kryesore lumore, nga veriu në jug, lumenjtë e Drinit dhe Bunës, Lumin Mat, Lumenjtë Ishëm dhe Erzeni, Lumin Shkumbin, Lumin Seman dhe Lumin Vjosë. Këto sisteme lumore marrin ujë jo vetëm nga territori i Shqipërisë, por edhe nga pjesë të mëdha të zonave të banuara në Kosovë, Maqedoni dhe

Mal të Zi. Aktualisht, burimet e zhvilluara ujore në Shqipëri janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesën deri në vitin 2040 (MPPT 2012) dhe pabarazitë e vogla midis rajoneve mund të kapërcehen me lehtësi.

### Burimet për furnizimin me ujë. Shqipëria mbështetet kryesisht në burime nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm.

Furnizimi me ujë të pijshëm kryesisht vjen nga burime natyrore dhe rezerva nëntokësore (83%), me përjashtim të zonës metropolitane të Tiranës, e cila një pjesë të ujit e merr nga një burim ujqor sipërfaqësor në male (17%), ku është ndërtuar një digë për të krijuar një rezervuar, dhe për këtë arsye duhet medoemos të trajtohet, si edhe rezervuari i Maskurias që e merr ujin nga Liqeni i Maskurias për të furnizuar zonën turistike të Kavajës (Golem dhe një pjesë të plazhit të Durrësit) (ICPDR 2015). Cilësia e ujërave sipërfaqësore për rreth 80% të gjatësisë së lumenjve klasifikohet si e pranueshme (kategoria parë), në përputhje me standardet e Komisionit Ekonomik të OKB-së për Evropën (UNECE) (MPPT 2011). Kjo për shkak të faktit se aktiviteti industrial përgjatë shumicës së këtyre lumenjve është i kufizuar, prandaj edhe ndotja është shumë e pakët.


## ORGANIZIMI I SHËRBIMEVE

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidatë për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
Numri zyrtar i ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizime	2013	GDWSS 2013	58	75	661	n.a.
Numri i mesatar i popullsisë së shërbyer	2013	Çmuarje të autorëve	36,822	28,963	9,496	n.a.
Lloji mbizotërues i ofruesve të shërbimeve	Shoqëri aksionare të ujësjellës-kanalizimeve					
Fusha e shërbimit	Ujësjellës dhe/ose kanalizime					
Pronësia	Njësitë e qeverisjes vendore					
Shtirja gjeografike	Kryesisht disa NJQV					
Ka ligj për shërbimet e ujit?	Jo					
Ministri linje e vetme?	Po [Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës]					
Ent rregullator?	Po [ERRU]					
A publikohen treguesit e ecurisë së ndërmarrjeve?	Po [www.erru.al]					
A ka shoqatë kombëtare të ndërmarrjeve?	Po [SHUKALB për ujësjellës dhe kanalizime]					
Pjesëmarrja e sektorit privat	Vetëm i kontraktuar si i tretë					

### Ofrimi i shërbimeve. Njësitë e qeverisjes vendore, përmes asamblesë së aksionarëve, kanë autoritetin dhe përgjegjësinë e plotë për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Tani për tani, në Shqipëri ka 58 ndërmarrje të ujësjellës kanalizimeve në formën e SHA-ve, të cilat i shërbejnë afërsisht 77% të popullatës. Tridhjetë prej këtyre shoqërive i ofrojnë të dyja shërbimet: ujësjellës dhe kanalizime. Njëmbëdhjetë ofrojnë shërbime në disa bashki (për më shumë se 60 000 banorë), që përbëjnë thuhetse 67% të popullsisë në Shqipëri. Dyzet e dy shoqëri janë ndërmarrje të mesme ose të vogla që u shërbejnë më pak se 60 000 banorëve (Figura 1). Sipas Sektorit të Monitorimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, afërsisht 644 000 banorë që jetojnë në fshat (20% e popullsisë gjithsej) marrin furnizim me ujë nga bashkitë dhe komunat jashtë territorit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (GDWSS 2013).

FIGURA 1: LLOJET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE PJESËT QË ZËNË NË TREG



BURIMI: GDWSS 2013.

### Vendimmarrja për politikën dhe institucionet e sektorit. Sektori i ujësjellës kanalizimeve është i organizuar si një sistem me dy nivele, ku pushteti qendror është përgjegjës për strategjitë sektoriale dhe hartimin e politikave dhe njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve.

Në nivel qendror, palët më të rëndësishme të interesit janë (Figura 2):

- *Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës*, që është ministria e linjës, përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave të sektorit. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve është i vetmi institucion teknik i specializuar i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve që ka kompetencën për të bashkërenduar dhe monitoruar veprimtaritë e subjekteve të ujësjellës-kanalizimeve në të gjithë vendin. Kjo Drejtoria e Përgjithshme bashkërendon

- edhe shpërndarjen e subvencioneve dhe investimeve përmes Ministrisë së Financave.
- ▶ **Këshilli Kombëtar i Ujit** është organi kryesor ndërinstitucional përgjegjës për hartimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, dhe që ushtron aktivitetet në bazë të Ligjit Nr. 111/2012. Këshilli kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga shtatë ministritë kryesore që janë palë interesi. Organi ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Ujit është Sekretariati Teknik, që është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të lidhura me burimet ujore të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit.
  - ▶ **Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave** dhe Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave dhe Tokës që është përgjegjëse për dhënien e lejeve mjedisore, monitorimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe mbajtjen në kontroll të ndotjes së ujërave.
  - ▶ **Ministria e Financave**, që është përgjegjëse për financimin e investimeve kapitale në këtë sektor.
  - ▶ **Enti Rregullator i Ujit**, që është një organ rregullator i pavarur i cili, me ligj, përgjigjet drejtpërdrejt përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. ERRU jep licencat për ushtrimin e veprimtarisë në ujësjellës-kanalizime, dhe përcakton tarifat e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, si me shumicë ashtu edhe me pakicës. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë të cilët i emëron Këshilli i Ministrave. Kryetari emërohet me mandat pesëvjeçar, duke u zgjedhur një prej anëtarëve të Komisionit, ndërsa anëtarët e tjerë emërohen me mandat katërvjeçar. Asnjëri prej anëtarëve nuk ka të drejtë të rrimërohet në Komision për më shumë se dy mandate të plota.
  - ▶ **Fondi Shqiptar i Zhvillimit** është përgjegjës për shpërndarjen e fondeve të investimit në zonat rurale dhe jo tek shoqëritë e licencuara.
  - ▶ **Instituti i Shëndetit Publik/Ministria e Shëndetësisë**, që është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit (ujërave sipërfaqësore, ujit të pijshëm, ujërave të zeza) dhe për ndërhyrjen në rast të ndotjes aksidentale të ujërave.

### Kapacitetet dhe trajnimi. Shqipëria nuk ka personel të lartë teknik dhe drejtues që të jetë i trajnuar dhe i kualifikuar mjaftueshëm.


Trajnimi i personelit kryesisht është orientuar nga programet e herëpashershme të fuqizimit institucional të financuara nga donatorët. Mungesa e personelit teknik dhe financiar të trajnuar mirë në ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve ka çuar në mungesë të efikasitetit të operacioneve teknike dhe drejtimit financiar. Ky problem ndërlikohet nga zëvendësimi i shpeshtë i drejtorëve të NUK-ve me persona të emëruar politikisht që nuk i zotërojnë kualifikimet apo përvojën e nevojshme për postin që marrin. Ndërmarrjet nuk bëjnë trajnime rutinë për buxhetin por kanë treguar interes për trajnimet e propozuara nga Shoqata e Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë, në bazë të informacionit të Shoqatës. Kjo Shoqatë i kryen këto trajnime me mbulim të plotë të kostos. Mbështetja dhe zbatimi i programeve të rritjes së kapaciteteve për të arritur rritjen e aftësive profesionale të krahut të punës dhe për të arritur një "ndryshim të mentalitetit" lidhur me drejtimin e brendshëm të NUK-ve mbetet një sfida për këto ndërmarrje.

### Praktika e mirë

#### Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime Berat-Kuçovë

NUK Berat-Kuçovë është i vetmi shembull i agregimit me nismën e vet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, midis NUK Kuçovë dhe NUK Berat. Bashkimi i këtyre dy ndërmarrjeve bashkiake është zyrtarizuar me kontratë të negociuar midis aksionarëve të dy subjekteve. Faktori kryesor për këtë agregim ka qenë kriteri i vendosur nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) sipas të cilit mund të finançohej linja e transmetimit me rënie të lirë nga rrjeti i Beratit në rrjetin e Kuçovës vetëm nëse do të bashkoheshin të dy ndërmarrjet. Ky investim do t'i jepte mundësi rrjetit të Kuçovës të realizonte kursime të konsiderueshme në zërin e energjisë, duke shpenzuar për infrastrukturën e rrjetit dhe pajisje si matës uji dhe renovimi i rrjetit i dha mundësi shoqërisë së agreguar ta rriste në mënyrë të qëndrueshme ecurinë e shërbimeve. Pas vitit 2012, kjo ndërmarrje ka ndjekur një strategji tarifore me një strukturë të unifikuar tarife, me miratimin e Komisionit Rregullator të Ujit.

FIGURA 2: ORGANIZIMI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE



BURIMI: PËRGATITUR NGA AUTORËT

### Rregullimi ekonomik. Rregullimi ekonomik në Shqipëri, që ka qenë i pari i vendosur me ligj në rajon thuajse përpara 20

**vjetësh, po fuqizohet më tej.** Sektori i ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri rregullohet përmes një institucioni të pavarur publik, Entit Rregullator të Ujit (ERRU), i krijuar në vitin 1996. ERRU jep llogari drejtpërdrejt përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, tek të cilët raporton rregullisht me raport vjetor. Roli rregullator dhe funksionet kryesore të tij mbulojnë licencimin e të gjitha operacioneve të ofrojnë shërbimet publike të ujësjellës dhe/ose kanalizimeve dhe rregullimin e tarifave për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve dhe përballeshmërinë financiare për klientët. Enti monitoron edhe ecurinë e ofruesve të shërbimeve për të mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe për të nxitur përmirësimet e vazhdueshme të shërbimeve përmes vendosjes së objektivave të vështirë por të arritshëm. ERRU ofron një gamë metodikash për përcaktimin e tarifave që mbulojnë kostot për subjektet e licencuara të sektorit. Fuqizimi i rolit të ERRU-së ka qenë një prej pikave kryesore të Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Ujit dhe vazhdon të mbetet prioritet i programit të reformës sektoriale të Ujit.

### Reformat në zbatim ose në plan. Sektori i ujësjellës-kanalizimeve është mes të reformave të rëndësishme, pas hyrjes së Shqipërisë në një fazë të re të reformës Territoriale-Administrative.

Puna për përmirësimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri është bërë kryesisht në formë projektsh vertikale, me shumë pak ose aspak veprime horizontale mbarësektoriale. Kjo ka sjellë përmirësime disi jo të njëtrajtshme të ecurisë së sektorit. Me ndihmën e Bankës Botërore është hartuar një Strategji e Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2011-2017, me qëllim prezantimin një qasjeje të re për reformat e sektorit duke përcaktuar qartë objektivat strategjike dhe duke caktuar përgjegjësitë që i takojnë çdo institucioni për të hartuar plane të hollësishme veprimi në mbështetje të arritjes së këtyre objektivave. Strategjia ka përcaktuar pesë objektiva kyç që duhen arritur brenda periudhës së zbatimit të saj:

1. Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës kanalizimeve.
2. Orientimi i shërbimeve të Ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove.
3. Përmirësimi i drejtimit dhe rregullimit të sektorit.
4. Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit.
5. Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së për Ujin.

Secili objektivi është i lidhur me një sërë masash prioritare, të cilat konvertohen në objektiva strategjike të matshëm dhe me afat të përcaktuar. Masa prioritare 5.c synon zvogëlimin e numrit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve nga 58 në 26 brenda fundit të vitit 2017. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka rolin drejtues në monitorimin dhe shqyrtimin e ecurisë vjetore së planeve strategjike të veprimit. Reforma e tanishme Territoriale-Administrative, e cila synon shkrirjen e 374 NJQV-ve në 61 syresh, përbën një ndryshim madhor për ofrimin e shërbimeve në fshat, sepse njësitë administrative ekzistuese në nivel fshati, që shpesh realizojnë shërbime UK, do të bashkohen me bashki më të mëdha. Janë duke u përgatitur kadastra e Ujit dhe strategjia kombëtare për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

## MUNDËSIA E MARRJES SË SHËRBIMEVE


Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
<b>Furnizimi me ujë</b>						
Furnizim me tubacion – mesatarja [%]	2012	Çmuarje të autorëve	78	89	83	100
Furnizim me tubacion – 40% të fundit [%]	2012	Çmuarje të autorëve	72	81	76	100
Furnizim me tubacion – nën 2,50 \$/ditë [PPP] [%]	2012	Çmuarje të autorëve	66	73	61	100
Duke përfshirë edhe furnizimin publik – mesatare [%]	2013	GDWSS 2013	77	71	74	99
<b>Kanalizime dhe ujëra të zeza</b>						
Tualet me ujë të rrjedhshëm – mesatare [%]	2012	Çmuarje të autorëve	89	90	79	99
Tualet me ujë të rrjedhshëm – 40% të fundit [%]	2012	Çmuarje të autorëve	82	81	70	98
Tualet me ujë të rrjed. – nën 2,50 \$/ditë [PPP] [%]	2012	Çmuarje të autorëve	79	76	54	100
Duke përfshirë edhe kanalizime – mesatare [%]	2013	GDWSS 2013	64	53	66	94
<b>Trajtim i ujërave të zeza</b>						
Të lidhur me impiant trajtimi të ujërave të zeza [%]	2013	Çmuarje të ekspertëve	13	9	45	95

**Mbulimi me shërbime. Ofrimi i shërbimit të ujit, dhe sidomos të shërbimit të kanalizimeve, në fshat nuk ka marrë vëmendjen e mjaftueshme.**

Sipas Sektorit të Monitorimit, afërsisht 2,6 milion banorë ka qenë popullata që ka marrë shërbime nga NUK-të në vitin 2013, që përbën 78% të popullsisë gjithsej që banon në territorin e të gjitha NUK-ve në Shqipëri (Figura 3). Në bazë të të dhënave, mbulimi me furnizim me ujë është 90% në qytet dhe 59% në fshat, ndërsa mbulimi me kanalizime është 84% në qytet dhe 12,5% në fshat. Shifra 84% mbulim në qytet konsiderohet nga Sektori i Monitorimit se është më e vogël se realiteti, duke qenë se shërbimi i kanalizimeve të ujërave të zeza ofrohet si shërbim komunal nga njësitë e qeverisjes vendore në disa zona qytetëse. Por njësitë e qeverisjes vendor nuk mbledhin, analizojnë apo raportojnë të dhëna në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Ofrimi i shërbimit të trajtimit të ujërave të zeza është ende i ulët, por pritet të rritet në mënyrë drastike në të ardhmen e afërt me futjen në shfrytëzim të impianteve të reja të trajtimit që janë në proces ndërtimi.

**Të dhënat mbi popullsinë**

Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë një problem kritik në Shqipëri. Disa burime zyrtare japin informacione kontradiktore për numrin e banorëve gjithsej në territorin e subjekteve të licencuara të ujësjellës-kanalizimeve. Për shembull, në bazë të evidencave të Gjendjes Civile, popullsia gjithsej në territorin e subjekteve të ujësjellës-kanalizimeve është 3,2 milion banorë, por regjistrimi i fundit i popullsisë (2011) nxori një numër banorësh të regjistruar në Shqipëri prej 2,8 milion. Nuk kuptohet qartë se cili burim duhet përdorur për të pasur numrin e saktë të popullsisë gjithsej.



**FIGURA 3: MUNDËSIA E MARRJES SË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE: POPULLSIA GJITHSEJ; 40% TË FUNDIT DHE SHTRËSAT E VARFRA**

BURIMI: LLOGARITJE TË AUTORËVE, GDWSS 2013 DHE ÇMUARJE TË EKSPERTËVE.

**Drejtësia në marrjen e shërbimeve. Pakicat kanë mundësi shumë të kufizuara të përfitimit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve.**

Sipas UNDP Bratislava 2012, kushtet e banimit dhe infrastrukturës për komunitetet rome dhe egjiptiane janë përkeqësuar gjatë viteve të fundit. Mbi 38% e familjeve rome dhe 45% e familjeve egjiptiane jetojnë në banesa të rrënuara, ndërsa 21% e familjeve rome dhe 11% e familjeve egjiptiane jetojnë në kasolle. Shumë prej këtyre familjeve nuk marrin furnizim me ujë të pijshëm, nuk kanë tualete brenda shtëpisë dhe nuk janë të lidhur me infrastrukturën e ujërave të zeza. Vetëm 66% e përqindjes më të varfër të popullsisë (të atyre që jetojnë me më pak se 2,50 \$ fuqi blerëse në ditë) janë të lidhur me ujësjellës dhe 79% kanë mundësinë e përdorimit të tualetit me ujë të rrjedhshëm (llogaritje të autorëve).

**Infrastruktura e shërbimeve. Infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri është e vjetër dhe ka nevojë për rritje të standardit.**

Shumica e ndërmarrjeve shfrytëzojnë rrjete që janë ndërtuar përpara më shumë se 60 vjetësh. Për pasojë, humbjet teknike janë të larta për shkak të rrjedhjeve. Gjatë dekadës së fundit, investimet janë orientuar kryesisht drejt rikonstruksionit dhe zgjerimit të infrastrukturës së ujit, duke lënë pas infrastrukturën e ujërave të zeza, sidomos në fshat. Për pasojë, gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është katër herë më e madhe se ajo e ujërave të zeza. Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, që janë në shfrytëzim, janë të pajisur me trajtim paraprak, parësor dhe dytësor. Vetëm një prej tyre, me vendndodhje në zonën e Durrësit (ndërmarrja e dytë më e madhe në Shqipëri, që ndodhet në zonë bregdetare) ka edhe trajtim terciar (një kombinim i trajtimit mekanik me ligatinë). Disa prej këtyre impianteve të trajtimit kanë hasur në probleme të konsiderueshme në lidhje me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për shkak të mungesës së burimeve teknike dhe financiare. Si një tregues i ecursisë, duhet rritur dhe monitoruar përqindja e ujërave të zeza që krijohen dhe shkarkohen në një rrjet kanalizimesh të lidhur me një impiant të përshtatshëm të trajtimit të ujërave të zeza.



Vlera	Vlera		Viti	Burimi
	Ujë	Ujëra të zeza		
Numri i impianteve të trajtimit	2	4	2012	GDWSS 2013 & Eurostat 2014
Gjatësia e rrjetit [km]	7,478	1,752	2012	GDWSS 2013
Lidhjet mesatare të rrjetit për km	84	221	2012	GDWSS 2013

## ECURIA E SHËRBIMEVE

### Cilësia e shërbimeve

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
Konsumi i ujit, familjar, [litra/frymë/ditë]	2013	GDWSS 2013	95	165	122	n.a.
Vijimësia e furnizimit me ujë [orë/ditë]	2013	GDWSS 2013	12	19	20	24
Cilësia e ujit të pijshëm [% e kampionëve që i plotësojnë kriteret]	2013	GDWSS 2013	98	83	93	99.9
Cilësia e trajtimit të ujërave të zeza [% e kampionëve që i plotësojnë kriteret BOD5]	—	—	—	n.a.	79	100
Blokimet e kanaleve të ujërave të zeza [numër/km/vit]	2013	IBNet 2015	15.0	9.3	5.0	0.2
Përbushja e nevojave të klientit [% e popullsisë që mendon se i janë përbushur nevojat nga shërbimet]	2013	Gallup 2013	58	63	63	95

**Cilësia e shërbimeve. Cilësia e shërbimeve në Shqipëri, megjithëse është duke u përmirësuar, mbetet larg standardeve të BE-së.** Vazhdueshmëria e furnizimit me ujë në vitin 2013 ishte mesatarisht 12 orë në ditë (GDWSS 2013). Megjithëse ky tregues është përmirësuar, ndërmarrjet e ujësjellësit vazhdojnë të kenë mbiproduhim uji në përpjekje për të plotësuar nevojat e popullsisë dhe për të respektuar orarin dhe trysinë e furnizimit. Vetëm dy ndërmarrje në Shqipëri (Korça dhe Librazhdi) janë në gjendje të bëjnë furnizim me ujë me presion në të gjithë rrjetin 24 orë në ditë gjatë gjithë vitit. Në rrjetet e tjera, banorët kanë marrë masa për ndërprerjet e shërbimit, duke e plotësuar këtë me blerjen dhe instalimin e pompave shtytëse dhe të depozitave të ujit. Pavarësisht masave mbrojtëse të zbatuara në burimet e ujit, të gjithë ujësjellësit në Shqipëri bëjnë trajtim të vazhdueshëm me klor për të eliminuar kontaminimin nga mikroorganizmat. Parrezikshmëria e furnizimit me ujë monitorohet nga Sekretariati Sanitar Shtetëror në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Sekretariati bën analiza për të parë sa është klori i mbetur në pika të ndryshme të përdorimit dhe për të parë sa është sasia e baktereve koliforme. Niveli i përbushjes së kriterëve në vitin 2013 ishte 97% për klorin e mbetur në ujë dhe 98% për bakteret koliforme (GDWSS 2013). Megjithëse ende nuk matet në mënyrë të njëtrajtshme cilësia e trajtimit të ujërave të përdorur, të gjithë impiantet janë të rinj dhe pritet të funksionojnë në përputhje me projektin dhe me standardet e përcaktuara.

#### Praktika e mirë

##### Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime Korçë

Korça UK sha është NUK lider në Shqipëri. Ajo ka për mision furnizimin e vazhdueshëm, të sigurt, të mjaftueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj në përputhje me normativat në fuqi. Korça ka qenë një prej NUK-ve të para në Shqipëri që janë përzgjedhur nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) për të vënë në zbatim programe madhore investimesh. Më parë, situata në Korça UK ka qenë shumë e vështirë, ku treguesi i ujit pa të ardhura ishte 80% dhe furnizimi ishte vetëm 4-6 orë në ditë. Përmes një udhëheqjeje dhe administrimi të përkushtuar, Korça është bërë një nga ndërmarrjet më të suksesshme të Ballkanit Perëndimor dhe shoqëria me rezultate më të mira në Shqipëri, duke siguruar furnizim të pandërprerë me ujë.

**Përbushja e pritshmërisë së klientëve. Niveli i përbushjes së pritshmërisë së klientëve dhe perceptimet e qytetarëve për realizimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve nuk monitorohen sa duhet apo rregullisht.** Ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve u mungojnë procedurat për të marrë, analizuar dhe ndjekur vërejtjet dhe sugjerimet e klientëve. Në vitin 2012 ERRU ndërmori një vërtetim të perceptimeve të klientëve për shërbimet ujësjellës-kanalizime, me synim dhënien e mendimeve për vendimmarrjen për politikën, rregullimin dhe administrimin e shërbimit për klientin në nivel ndërmarrjeje. Sipas një sondazhi të zhvilluar nga GALLUP INTERNATIONAL në vitin 2013, 58% e shqiptarëve janë të kënaqur me shërbimin e ujit që marrin. Ky nivel është i ulët në krahasim me vendet e tjera të rajonit të Danubit.


## Efikasiteti i shërbimeve

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
Uji pa të ardhura [%]	2013	GDWSS 2013	67	50	35	16
Uji pa të ardhura [ $m^3/km/ditë$ ]	2013	IBNet 2015	68	41	35	5
Produktiviteti i personelit [ujësjellës-kanalizime] [numër punonjësish/1000 lidhje]	2013	GDWSS 2013	5.6	11.5	9.6	2.0
Produktiviteti i personelit [ujësjellës-kanalizime] [numër punonjësish/1000 banorë që marrin shërbim]	2013	IBNet 2015	1.4	2.4	1.7	0.4
Niveli i arkëtimit [arkëtime/faturime] [%]	2013	GDWSS 2013	82	85	98	116
Niveli i pajisjes me matës [lidhjet me matës/lidhje] [%]	2013	GDWSS 2013	59	81	84	100
Indeksi i ecurisë së NUK-ve [WUPI]	n.a.	Llogaritje të autorëve	51	59	69	94

**Efikasiteti i përgjithshëm. Efikasiteti i ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizime mbetet një problem kyç për Shqipërinë.** Për vitin 2013, prodhimi i ujit gjithsej ishte afërsisht 273 milion  $m^3$  në vit, ndërsa shitjet gjithsej të ujit ishte 90 milion  $m^3$ . Pra, çmohet se uji pa të ardhura është në nivelin 67% dhe nuk mund të konsiderohet vetëm si humbje teknike. Madje, dihet mirë se shumica e ujësjellësve në Shqipëri kanë një numër të konsiderueshëm lidhjesh “të paligjshme” ose “të pargjistruara” në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Kjo do të thotë se një pjesë e nivelit prej 67% të ujit pa të ardhura në fakt shfrytëzohet dhe mund të quhet si shërbim. Po kështu, niveli i pajisjes së konsumatorëve me matës është ende i ulët (59%), çka tregon se, në nivel vendi, nuk ka informacion të qartë dhe matje për nivelin real të konsumit të ujit. Për të pakësuar ujin pa të ardhura, do të duhen përpjekje të fokusuar për menaxhimin e kërkesës për ujë dhe përmirësimin e nivelit të instalimit të matësve. Nga këto përpjekje pritet të nxisin një sjellje racionale nga konsumatorët, të cilët në fund do ta marrin faturën në bazë të vëllimit të përdorur. Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve janë të mbipopulluara me personel, sidomos ndërmarrjet e vogla dhe ato në fshat. Raport mesatar kombëtar i personelit në vitin 2013 ishte 5,6 punonjës për 1000 lidhje me ujësjellës-kanalizime, që është shumë më lart se praktika e mirë në rajon. (GDWSS 2013).


**Tendencat e fundit. Shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve jo gjithmonë perceptohen nga konsumatorët si veprimtari tregtarë për të cilat duhet paguar.** Mospagimi nga klientët duhet të shoqërohet me zbatimin e rreptë të politikave për ndërprerjen e shërbimit dhe me ndjekje ligjore rigoroze kundër klientëve që nuk pranojnë t'i paguajnë faturat e ujit. Gjatë 8 viteve të fundit është arritur një progresi i ngadaltë sa i takon efikasitetit. Megjithëse, siç duket edhe nga Figura 4, vitet e fundit është rritur niveli i përgjithshëm i arkëtimit, mesatarja vjetore për të gjithë vendin vijon të luhatet nga viti në vit, nën ndikimin e zgjedhjeve parlamentare dhe vendore. Pritet që situata të përmirësohet në të ardhmen, duke qenë se tani qeveria është duke e çuar përpara reformën në sektorin e energjisë elektrike duke punuar fuqimisht për ta rritur nivelin e arkëtimit të faturave të energjisë elektrike, çka ka sjellë rezultate pozitive edhe për pagimin e faturave të ujit. Me të vërtetë, kjo ka çuar në rritje të ndërgjegjësimit të klientëve për pagimin e faturave të ndërmarrjeve shtetërore dhe komunale.

**FIGURA 4: ZHVILLIMI I NIVELIT TË ARKËTIMIT TË FATURAVE NË NDËRMARRJET SHQIPTARE**



BURIMI: GDWSS 2013

**FIGURA 5: FINANCIMI GJITHSEJ I SEKTORIT TË NUK NË 2013**



BURIMI: LLOGARITJE TË AUTORËVE.

# FINANCIMI I SHËRBIMEVE


## Financimi i sektorit

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
<b>Burimet e financimit</b>						
Financimi i sektorit gjithsej [€/frymë/vit]		Llogaritje të autoreve	32	29	62	n.a.
Financimi i sektorit gjithsej [% e PBB-së] [%]		Llogaritje të autoreve	0.39	0.34	0.45	n.a.
Përqindja e kostos së shërbimeve të financuar nga tarifat		Llogaritje të autoreve	50	67	67	n.a.
Përqindja e kostos së shërbimeve të financuar nga tatimet		Llogaritje të autoreve	26	17	13	n.a.
Përqindja e kostos së shërbimeve të financuar nga transfertat		Llogaritje të autoreve	24	16	20	n.a.
<b>Shpenzimet për shërbimet</b>						
Investimet vjetore mesatare [% e financimit të sektorit gjithsej] [%]		Llogaritje të autoreve	48	32	38	n.a.
Investimet vjetore mesatare [€/frymë/vit]		Llogaritje të autoreve	15	9	23	n.a.
Çmuarje e investimeve që janë të nevojshme për të arritur objektivat [€/frymë/vit]	2012-2040	MPWT 2012	63	37	43	n.a.
Nga të cilat, pjesa e menaxhimit të ujërave të zeza [%]		Llogaritje të autoreve	80	70	61	n.a.

**Financimi i përgjithshëm i sektorit. Tarifat përbëjnë 50% të burimeve të financimit të sektorit.** Pushteti qendror ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve nga donatorët dhe buxheti i shtetit për investime kapitale, në bazë të vlerësimit të nevojave përmes planeve kuadër kombëtare dhe nevojave të shprehura nga njësitë e qeverisjes vendore. Pushteti qendror del edhe dorëzanë si shtet për kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe u jep ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve subvencione korente për mbulimin e kostove të energjisë.

Në vitin 2013, të ardhurat nga tarifat përbënin rreth 50% të burimeve të financimit gjithsej të sektorit, duke mbuluar 94% të kostove të shfrytëzimit (Figura 5). Mbatja e tarifave artificialisht në një nivel të ulët çon në një rreth vicioz të fondeve të pamjaftueshme të ofruesve të shërbimeve, investimeve të pamjaftueshme dhe përkeqësimit të infrastrukturës. Burimi kryesor i financimit të NUK-ve paraqiten në Figurën 6, e cila është hartuar në bazë të metodikës së 3 T-ve të OECD-së ("tarifat, transfertat dhe tatim-taksat").

**FIGURA 6: BURIMET KRYESORE TË FINANCIMIT TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE**



BURIMI: PËRGATITUR NGA AUTORËT

## Nevojat për investime. Kohët e fundit Qeveria e Shqipërisë ka hartuar dhe miratuar një Master-plan kombëtar për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, si një instrument themelor për planifikimin e investimeve në nivel qendror.

Ky master-plan bazohet në një analizë të sektorit dhe merr në konsideratë strategjitë dhe politikat kombëtare. Përmes këtij instrumenti, bëhet një renditje e prioritetëve të projekteve për të mbështetur përdorimin e qëndrueshëm të fondeve të investimeve në përputhje me argumentet e sektorit dhe politikat për zhvillimi. Në bazë të prioritetëve, bëhet renditja e investimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata duke marrë në konsideratë investimet e vendit dhe ato të huaja për ujësjellës-kanalizime. Në Tabelën 1 jepen investimet gjithsej të identifikuar për sektorët ujë dhe kanalizime për periudhën 2012–2040. Çmohet se 63 €/frymë/vit janë të nevojshme për të financuar investimet (MPPT 2012). Por ky master-plan mbetet ende për t'u aprovuar me VKM.

TABLE 1: NEVOJAT PËR INVESTIME, 2012-2040.

Sektori	Përshkrimi	Rikonstruksion	Zgjerim	Të reja	Gjithsej	%
Ujësjellës	Brenda ndërmarrjes	530.5	352.7	3.4	886.6	17.45%
	JTM	0.0	0.0	154.7	154.7	3.04%
	Total	530.5	352.7	158.1	1041.3	20.50%
Kanalizime	Brenda ndërmarrjes	285.2	1 714.0	482.1	2 481.3	48.84%
	Brenda ndërmarrjes	0.0	185.8	39.9	225.7	4.44%
	JTM	1.3	15.5	1 280.0	1 296.8	25.31%
	JTM	0.0	0.7	45.7	46.4	0.91%
	Gjithsej	286.5	1916.0	1847.7	4 050.2	79.5%
Gjithsej		817.0	2268.7	2005.8	5 091.5	100%

BURIMI: MPPT 2012.; SHËNIM: JTM – JASHTË TERRITORIT TË MBULIMIT

Tetëdhjetë për qind e nevojave të identifikuara për investime planifikohet të përdoren për menaxhimin e ujërave të zeza (zgjerim i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ndërtim i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza), që përputhet me ambicet e vendit për integrim në BE.



## Investimet. Nivelet e investimeve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri janë djeshëm më të ulëta se nevojat.

Infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri është e vjetër, e dëmtuar dhe pa efikasitet. Ndryshimet demografike që kanë ardhur nga migrimi i popullsisë nga fshati në qytet, pas ndryshimit të regjimit në vitin 1991, dhe rritjet e mëdha të mëpasshme të kërkesës për shërbime të ujësjellës-kanalizimeve e kanë përkeqësuar situatën, që edhe më parë ka qenë e keqe, me një infrastrukturë që shfrytëzohet në kapacitetin maksimal në shumicën e rasteve. Edhe pse vitet e fundit investimet janë rritur, sidomos tani së fundmi në drejtim të ujërave të zeza, këto investime nuk kanë qenë aq sa për të mbuluar nevojat për investime kapitale. Çdo vit janë investuar rreth 15 € për banor, me financim nga burime vendase dhe të huaja, siç tregohet edhe në Figurën 7.

## Mbulimi i koston dhe përballueshmëria


Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e vendeve kandidate për BE	Mesatarja për Danubin	Më e mira e Danubit
<b>Mbulimi i kostove</b>						
Tarifa mesatare për familjarë [ujësjellës-kanalizime] [€/m <sup>3</sup> ]	2013	GDWSS 2013	0.74	0.57	1.32	n.a.
Kosto për njësi shfrytëzim dhe mirëmbajtje [€/m <sup>3</sup> ]		Llogaritje të autorëve	0.62	0.45	1.20	n.a.
Mbulimi i kostove të shfrytëzimit [faturim/shpenzime të shfrytëzimit]	2013	GDWSS 2013	0.95	1.01	0.96	1.49
<b>Përballueshmëria</b>						
Pjesa që zënë shpenzimet e mundshme për UK në të ardhurat mesatare [%]	2012	Llogaritje të autorëve	2.2	1.6	2.6	n.a.
Pjesa që zënë shpenzimet e mundshme për UK në të ardhurat e 40% të fundit [%]	2012	Llogaritje të autorëve	3.3	2.5	3.8	n.a.
Përqindja e familjeve me shpenzime të mundshme për UK mbi 5% të ardhurave mesatare [%]	2012	Llogaritje të autorëve	3.1	1.6	14.1	n.a.

**FIGURA 7: INVESTIMET NË UJËSJELLËS-KANALIZIME**



SOURCE: GDWSS 2013.

**Mbulimi i kostove me të ardhurat. Shumica e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve nuk janë në gjendje t'i mbulojnë kostot e shfrytëzimit, për shkak të tarifave të ulëta, nivelit të ulët të arkëtimit të faturave, nivelit të lartë të ujit pa të ardhura dhe mungesës së përgjithshme të efikasitetit në shërbime.** Shkalla mesatare e mbulimit të kostove gjithsej nga të ardhurat e faturuara arrin 74,4%, ndërsa në bazë të arkëtimit është 61,2% (Figura 8). Duke marrë në konsideratë strukturën e kostove gjithsej të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve për vitin 2013, dy shpenzimet kryesore të shfrytëzimit mbeten kostot e energjisë (22%) dhe kostot e personelit (31%). Pushteti qendror jep subvencione në mbështetje të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, që nuk bën gjë tjetër veçse çon në mbështetje të mungesës së efikasitetit të administrimit.



**FIGURA 8: MBULIMI I KOSTOVE GJITHSEJ, 2013**


BURIMI: LLOGARITJE TË AUTORËVE

**Sektori i Monitorimit**


Republika e Shqipërisë menaxhon që prej vitit 2005 një program të monitorimit dhe vlerësimit krahasues të ecurisë së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve. Deri në dhjetor 2013 qenë mbyllur 8 cikle vjetore me të dhëna. Ky program është pjesë e përhershme e strategjisë së monitorimit dhe menaxhimit që ka Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Si rezultatet i investimeve kapitale dhe ngritjes së kapaciteteve, ky sektor po shërben gjithnjë e më shumë si një mjet i vyer për pushtetin qendror në vlerësimin e përmirësimit të ecurisë në të gjithë sektorin.

**Tarifat. Tarifat janë rritur gradualisht në shifra reale dhe do të vazhdojnë të rriten edhe në të ardhmen e afërt.** Tarifa për ujë të pijshëm dhe ujëra të përdorura është 0,74€/m<sup>3</sup> dhe është nën mesataren e rajonit. Megjithatë strategjia kombëtare bën të ditur se procesi i rishikimit të tarifave duhet gjithmonë të synojë mbulimin e plotë të kostove (përfshirë edhe shlyerjen e borxhit dhe financimin e rezervave për të përballuar amortizimin e aktiveve), analiza e zhvillimeve ka treguar se çmimi mesatar për metër kub është më i ulët se kostoja mesatare për metër kub (Figura 9).


**FIGURA 9: ZHVILLIMI I TARIFAVE UJËSJELLËS-KANALIZIME DHE KRAHASIM I KOSTOS ME ÇMIMIN**



BURIMI: LLOGARITJE TË AUTORËVE.



**FIGURA 10: PËRBALLUESHMËRIA E TANISHME E TARIFAVE UJËSJELLËS-KANALIZIME PËR GRUPET ME TË ARDHURA TË NDRYSHME, MESATARE DHE 40% TË FUNDIT**



BURIMI: LLOGARITJE TE AUTOREVE


**Përballueshmëria. Shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri janë të përballueshme financiarisht për një përqindje të lartë të popullsisë.**

Fatura e ujit për një familje mesatare zë 2,2% të të ardhurave të familjes, ose më shumë se 3% për 40% familjeve më të ardhura më të pakta të popullsisë (Figura 10). Pra mbetet nën pragun prej 5%, që është një tregues i përdorur nga ERRU. Janë bërë orvatje për të hartuar një mekanizëm adekuat subvencionesh në ndihmë të familjeve të varfra, por kjo nuk është vënë asnjëherë në zbatim.

Tarifat e mbajtura artificialisht në nivele të ulëta për të gjithë klientët çojnë në një rreth vicioz me ofrues shërbimesh pa fonde, investime kapitale të pamjaftueshme dhe infrastrukturë të amortizuar. Për shkak të të ardhurave të ulëta, subjektet e ulin edhe më tej nivelin e cilësisë së shërbimeve që u japin përdoruesve, çka e ul edhe më tej gatishmërinë e klientëve për t'i paguar këto shërbime me cilësi të ulët.

## QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT TË UJIT DHE VËSHTIRËSITË KRYESORE

Për të vlerësuar dhe pasqyruar qëndrueshmërinë e shërbimeve të rajonit, është realizuar një vlerësim i përgjithshëm i qëndrueshmërisë së sektorit, duke marrë në konsideratë katër dimensione: mundësia e përfitimit të shërbimeve, cilësia e shërbimeve, efikasiteti i shërbimeve dhe financimi i shërbimeve. Secili prej këtyre dimensioneve matet përmes tre treguesve të thjeshtë dhe objektivë. Për secilin tregues janë parë vlerat e praktikës më të mirë, në bazë të atyre që kanë ecurinë më të mirë në rajon, dhe vendet që u afrohen më shumë këtyre konsiderohen se kanë një sektor më të maturuar. Në Raportin rajonal të Sektorit, të hartuar nga Programi i Ujit i Danubit, jepet në shtojcë një përshkrim më i plotë i metodikës së vlerësimit të maturitetit të sektorit. Rezultatet e këtij vlerësimi për sektorin shqiptar të ujësjellës-kanalizimeve paraqiten në Figurën 11, që tregon edhe nivelin mesatar dhe atë më të mirë në rajonin e Danubit. Rezultati i qëndrueshmërisë së sektorit për Shqipërinë është 55, që është nën nivelin mesatar prej 64 të rajonit të Danubit. Mesatarisht, vlerësimi tregon se Shqipëria ka ecuri të mirë sa i takon mundësisë për të marrë ujë me tubacion dhe për të pasur tualet me ujë të rrjedhshëm, që tregon se mund të ketë vend për rritje të tarifave. Mangësitë kryesore të sektorit të ujit në Shqipëri, të identifikuar përmes vlerësimit të qëndrueshmërisë së sektorit, janë niveli i ujit pa të ardhura, mbulimi me trajtim të ujërave të zeza dhe trajtim të ujërave të zeza dhe niveli i investimeve.



**FIGURA 11: VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT: SHQIPËRIA**

BURIMI: PUNIM I AUTORËVE

Vëshirësitë kryesore të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve janë:

- ▶ **Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve.** Objektivi afatgjatë i Qeverisë në fushën e ujësjellës-kanalizimeve është arritja e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve në fshat dhe në qytet në përputhje me standardet që kërkon anëtarësimi në BE. Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve nuk i përmbushin mjaftueshëm parimet e mbajtjes së kostove nën kontroll, përmirësimi të vazhdueshëm të efikasitetit dhe mbulimit të plotë të kostove, çka shkakton një rreth vicioz me ofrues shërbimesh pa fonde, investime të pamjaftueshme dhe infrastrukturë të amortizuara.
- ▶ **Përkthimi i efektit të reformës territoriale në shërbime ujësjellës-kanalizime për të gjithë, sidomos në fshat.** Një pjesë jo a papërfillshme e popullsisë në fshat nuk merr ujë me tubacione. Reforma e planifikuar territoriale-administrative eliminon një numër të madh njësisish të qeverisjes vendore në zonat rurale, të cilat tani ofrojnë shërbime UK, të cilat do të duhet të integrohen në një strukturë të re të ofrimit të shërbimeve. Qeveria duhet të shikojë të mirat dhe të këqijat e alternativave të tilla si kalimi tek ndërmarrjet ekzistuese i detyrës për ofrimin e shërbimeve të ujit në fshat, krijimi i mekanizmave mbështetës për ofruesit e shërbimeve me bazë komunitetin ose bashkimi dhe agregimi i mëtejshëm i ndërmarrjeve. Duke pasur parasysh ecurinë e kufizuar të subjekteve në qytet dhe nevojat e konsiderueshme të zonave në fshat, me rëndësi të veçantë do të jetë kryerja e një analize të shkaqeve që kanë çuar në pabarazitë e tanishme, përpara se të marrë formë përfundimtare çdo vendim. Krijimi i mekanizmave dhe stimuljeve të llogaridhënies do të jetë thelbësor për të siguruar që nga reforma të përfitojnë të gjithë shtetasit dhe jo vetëm ata që i marrin shërbimet aktualisht.
- ▶ **Rritja e kapacitetit të fuqisë punëtore të sektorit të ujit.** Niveli i tanishëm i pajisjes me personel të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve është mbi standardet rajonale dhe ka qarkullim të konsiderueshëm të personelit, çka e pengon rritjen e nivelit profesional të ofrimit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve. Nevojitet mbështetje për rritjen e kapaciteteve, për ta përforcuar krahun profesional të punës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Kjo mund të bëhet përmes programeve të afirmuar të trajnimit dhe certifikimit të personelit. Përtej nevojës për të mbështetur trajnimin për zhvillimin e kapaciteteve, që me ligj është pjesë e mandatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të administrimit teknik dhe financiar më efikas të shërbimeve do të ishte kalimi tek certifikimi me provim i aftësive për postet kyçe të ndërmarrjeve.

## BURIMET

- ▶ Banka Botërore. 2015. *Treguesit Botëror të Zhvillimit*. Marrë në 2015. <http://databank.worldbank.org/data/views/reports/tableview.aspx>.
- ▶ Eurostat. 2014. *Komisioni Evropian, Drejtorja e Përgjithshme e Eurostat-it: Statistics Explained - Water Statistics (Shpjegim i statistikave: statistikat e sektorit të ujit)*. Marrë në 2015. [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Water\\_statistics](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Water_statistics).
- ▶ FAO Aquastat. 2015. *Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë – Baza e të dhënave AQUASTAT*. Marrë në 2015. <http://www.fao.org/nr/water/aquastat/data/query/index.html?lang=en>.
- ▶ Gallup. 2013. *World Poll (Sondazh botëror)*. Marrë në 2015. <http://www.gallup.com/services/170945/world-poll.aspx>.
- ▶ GDWSS. 2013. *Water Survey (Vrojtje e sektorit të ujit)*. Tiranë: Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Sektori i Monitorimit, Republika e Shqipërisë.
- ▶ IBNet. 2015. *Rrjeti Ndërkombëtar i Vlerësimit Krahasues për Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve*. Marrë në 2015. <http://www.ib-net.org>.
- ▶ ICPDR. 2015. *Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit të Danubit*. Marrë në 2015. <http://www.icpdr.org>.
- ▶ MPPT. 2011. *Strategjia Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2011-2017*. Tiranë: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Republika e Shqipërisë.
- ▶ —. 2012. *Master-plani për Sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë 2012-2040*. Tiranë: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Republika e Shqipërisë.
- ▶ MSHÇV. 2014. *Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore i Republikës së Shqipërisë: Pyetje të zakonshme për Reformën Administrative-Territoriale*. Marrë në 2015. <http://www.reformaterritoriale.al/en/reform/faq>.
- ▶ UNDP Bratislavë. 2012. *UNDP/Banka Botërore/KE, Vrojtje rajonal mbi romët 2011*. Bratislavë: Zyra Rajonale e UNDP-së.



# PROFILI I VENDIT: SHQIPËRIA



**WORLD BANK GROUP**  
Water



International Association  
of Water Supply Companies  
in the Danube River  
Catchment Area

Banka Botërore/Programi i Ujit për Rajonin e Danubit mbështet politika inteligjente, ndërmarrje të fuqizuara dhe shërbime të qëndrueshme në fushën e ujësjellës-kanalizimeve në Rajonin e Danubit, duke u lidhur në partneritet me palët e interesit në nivel rajonal, qendror dhe vendor, për të nxitur një dialog mbi politikat, të mbështetur me evidenca, në lidhje me vështirësitë e sektorit dhe për të kapacitetin teknike dhe administrues të ndërmarrjeve dhe institucioneve të sektorit.



**DANUBE  
WATER  
PROGRAM**

Smart policies, strong utilities, sustainable services

[www.danube-water-program.org](http://www.danube-water-program.org) | [www.danubis.org](http://www.danubis.org) | [SoS.danubis.org](http://SoS.danubis.org)  
[office@danube-water-program.org](mailto:office@danube-water-program.org)